

**VENDIM**  
**Nr.756, datë 28.5.2008**

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE, PYJE DHE KULLOTA,**  
**QË DO TË TRASFEROHEN NË PRONËSI TË NJËSISË SË QEVERISJES VENDORE,**  
**BASHKIA DIVJAKË, TË QARKUT TË FIERIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe të nenit 23 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, pyje dhe kullota, që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ të njësisë së qeverisjes vendore, bashkia Divjakë, të qarkut të Fierit, që do t'i transferohen në pronësi kësaj njësie.

2. Lista përfundimtare e pronave të paluajtshme, pyje dhe kullota, me 1 (një) fletë, që përfundon me numrin rendor 5 (pesë), dhe lidhja nr.1 i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe bashkia Divjakë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**2. FORMULAR PËR TRANSFERIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE**

(Mbështetur në inventarizimin e pronave të veçanta të tipit: kullota, livadhe, shkëmbore etj.)

Institucioni i pushtetit qendror: MMPAU

Bashkia: Divjake

Fusha e përdorimit të pronës: pyll

| Nr . | INV sipas VK M | Emërtesa e ekonomisë pyjore ose kullosore | Emërtesa e ngastrës, vendndodhja sipas emërtesës popullore | Nr. ngas. | Destinacioni | Sipër f ha. | Funksioni për të cilën përdoret pronë | Institucioni, enti me përgjegjësi administrative | Institucioni, enti përdorues, statusi i përdorimit | Të dhëna të tjera të veçanta |
|------|----------------|-------------------------------------------|------------------------------------------------------------|-----------|--------------|-------------|---------------------------------------|--------------------------------------------------|----------------------------------------------------|------------------------------|
| 1    | 366            | Gradisht Gjeneruke                        | Maja Fikut                                                 | 18        | Pyll         | 4           | Prodhues                              | M M P A U                                        | D S H P                                            |                              |
| 2    | 367            | Gradisht Gjeneruke                        | Gropa e Zeze                                               | 19/a      | Pyll         | 25.9        | Prodhues                              | M M P A U                                        | D S H P                                            |                              |
| 3    | 368            | Gradisht Gjeneruke                        | Fieri i Bardhe                                             | 20        | Pyll         | 21.7        | Prodhues                              | M M P A U                                        | D S H P                                            |                              |
| 4    | 369            | Gradisht Gjeneruke                        | Fieri i Bardhe                                             | 21/a      | Pyll         | 29.1        | Prodhues                              | M M P A U                                        | D S H P                                            |                              |
| 5    | 370            | Gradisht Gjeneruke                        | Fieri i Bardhe                                             | 21/b      | Pyll         | 25.7        | Prodhues                              | M M P A U                                        | D S H P                                            |                              |

| <b>Numrat rendorë të<br/>pronave në listën e<br/>inventarit</b> | <b>Fusha e përdorimit të<br/>pronës</b> | <b>Lloji i transferimit</b> |
|-----------------------------------------------------------------|-----------------------------------------|-----------------------------|
| 366 - 370                                                       | Pyll                                    | Në pronësi                  |
|                                                                 |                                         |                             |
|                                                                 |                                         |                             |